



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 141 Datë 08.10.2012

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË
FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA KESH SH.A PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012
– 2014 NË ZBATIM TË “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË
TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË”**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 78, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë”,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për rishikimin e tarifës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a në zbatim të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI